



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 17

Prishtinë, më 12. 10. 2011, në orën 10.00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj, Biserka Kostiq Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Ismet Beqiri dhe Kymete Bajraktari.

Munguan: Duda Balje dhe Justina Pula.

Pjesëmarrës të tjerë: Elita Vokshi dhe Floriana Shala- OSBE, Ukë Gashi- ZPRK, Visar Bivolaku- EUSR, Florije Kryeziu- UNICEF dhe Nuredin Ibishi Këshilltar i Kryetares të Komisionit nga CDF-i.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj- koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Mbledhjen e drejtoi Suazan Novoberdali, kryetare, e cila konstatoi se në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes dhe propozoi këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës,
 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 15 dhe 28 shtator 2011,
 3. Miratim i planit të punës të Komisionit për periudhën shtator- dhjetor 2011,
 4. Shqyrtimi i kërkesës së Këshillit Organizativ lidhur me rastin “Kiqina”,
 5. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit,
 6. Te ndryshme.
- .

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja propozoi që pika e katërt e rendit të ditës të shqyrtohet si pikë e tretë, ndërsa pika e tretë të kalojë në pikën e katërt.

Rendi i ditës u miratua me këtë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 15 dhe 28 shtator 2011

Kryetarja konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 15 dhe 28 shtator u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i kërkesës se Këshillit Organizativ lidhur me rastin “Kiqina”.

Ismet Beqiri- Tha se ky petition ishte objekt shqyrtimi edhe në legjislaturën e tretë dhe pyeti se a ka rrethana të reja apo jo, që të studiohet lënda. Pra, na vije keq nëse dikush është dënuar pa argumente, por nuk bie në fushëveprimin e Komisionit për të dhënë përfundime lidhur me gjykimin, prandaj kjo çështje i bie gjyqësorit. Ai më tutje shtoi se duhet të shikohet kërkesa e Këshillit Organizativ, a i plotëson kushtet formalo- juridike dhe nëse i plotëson, atëherë Komisioni do të marrë rekomandim lidhur me këtë çështje dhe do ta njoftojë Kryesinë e Kuvendit të Kosovës.

Kurtan Kajtazi- Duke u ndërlidhur me petitionin, si dhe me diskutimin e parafolësit shtoi se qytetarët e Kosovës, lidhur me petitionin kanë dhënë mendime se gjykim ishte jo i drejtë. Prandaj Komisioni nuk mundet dhe as që jemi kompetent të konstatojmë se a ka qenë gjykim i drejtë apo jo? Mirëpo, duke u bazuar se janë të deponuara pesëdhjetë mijë nënshkrime, ku dyzet e tetë mijë janë të identifikuar me letërnjoftim dhe nuk janë pak për një kërkesë. Pra, si anëtar i Komisionit jam që të kërkohet një debat parlamentar në Kuvend, por për lejimin të vendos Kryesia e Kuvendit.

Albana Gashi – Duke u ndërlidhur me petitionin theksoj që pesëdhjetë mijë nënshkrime nuk janë pak, nuk janë një pjesë e vogël e qytetareve për t'u injoruar. Në petition ata e kanë cekur shumë mirë se nuk po kërkojnë të ndërhyjnë në punë të gjyqësorit, dhe që 8 vite nuk janë pak e nuk kanë mundur të gjejnë zgjidhje dhe meqë gjykata ka marrë njëherë vendim jo të drejtë, kush na garanton që edhe në shkallën tjetër nuk do merret një vendim i tillë. Prandaj i janë drejtuar Kuvendit dhe e kanë theksuar se Kuvendi është i obliguar ta bejë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, sa është zbatuar ligji duke filluar nga ndalja, arrestimi i tyre e kështu me radhë.

Unë mendoj që çështja t'i procedohet Kuvendit për debat.

Rita Hajzeraj – I mbështeti parafolësit dhe u pajtua që çështja e ngritur t’i procedohet Kryesisë së Kuvendit dhe lidhur me çështjen të vendosi Kryesia për lejimin e debatit, ose për lejimin e një seance, ku do të debatohet kjo çështje.

Kryetarja- Duke u ndërlidhur me formalitetin e peticionit pyeti se a është konstatuar vlefshmëria e nënshkrimeve që janë në peticion dhe a ka ndonjë dëshmi të re në raport me peticionin, i cili ka qenë objekt shqyrtimi në legjislaturën e tretë.

Biserka Kostic - Bëri vërejtje për shkak se materiali nuk iu kishte ofruar në gjuhën e saj dhe tha se materialet që keni për diskutim për sot nuk i kam në gjuhën time. Ajo lidhur me këtë çështje tha se disa herë këtë çështje e kam ngritur. Lidhur me këtë koordinatori, bashkë me zyrtaren ligjore që e mbështet Komisionin, e njoftoi se materiali gjithmonë i dorëzohet në të dy gjuhët, sipas nenit 78 të Rregullores së Kuvendit. Kryetarja theksoi se me kohë janë dorëzuar dokumentet në gjuhën serbe, por apeloj që materiali secilit t’i dorëzohet në gjuhën amtare.

Biserka Kostic – Në diskutimin e serishëm kërkoi që dokumenti të jetë vetëm në gjuhën serbe, e mos të jenë kopjet e para në gjuhën shqipe.

Komisioni pas një debati konstruktiv dhe gjithëpërfshirës, që u zhvillua lidhur me peticionin dhe në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, votoi me katër vota pro dhe dy abstenime dhe lidhur me këtë nxori:

P e r f u n d i m

I. Komisioni me shumicë votash, vlerësoi se kërkesa e Këshillit Organizativ për rastin “Kiqina” i plotëson kushtet formale- juridike për një debat të mundshëm në Kuvend,

II. Bazuar në këtë i rekomandon Kryesisë që edhe njëherë ta vlerësojë dhe të marrë vendim përkatës lidhur me mundësin radhitjes për debat në njërën nga seancat plenare, ose mbajtjes se një debati parlamentar.

4. Miratim i planit të punës të Komisionit për periudhën shtator - dhjetor 2011

Kryetarja- I propozoi Komisionit për heqje nga rendi i ditës, pasi që projektplanin nuk është në gjuhën serbe.

5. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Mandate, Imunitet dhe Rregullore të Kuvendit.

Kryetarja- Tha se duhet të propozojmë që në rregullore duhet të behet ndryshimi sa i përket emërimit të Komisionit, sepse pas miratimit të ligjit për persona të zhdukur edhe Komisioni duhet të pësojë ndryshime në emërtim dhe të bëhet Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjimore, Persona të Zhdukur dhe Peticione. Komisioni i ynë është shumë i vlefshëm, i ka katër fusha të rëndësishme dhe se çdo projektligj që vjen në Kuvend duhet të shqyrtohet nga Komisioni se a cenohen të drejtat dhe lirit e njeriut. Ne duhet të

kërkojmë që Komisioni i ynë të bëhet Komision i përhershëm. Ne, lidhur me këtë çështje po i drejtohem me shkrim Komisionit për mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit.

6. Të ndryshme.

Kryetarja- Tha se sa i përket raportit të monitorimit të ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, kërkoj nga administrata që në mbledhjen e radhës të jetë në rend dite shqyrtimi dhe miratimi i këtij raporti. E falënderoj Albanën se ka bërë një punë shumë të mirë në monitorimin e këtij ligji. Kërkoj që në raport të cekët se viktimat del nga shtëpia, ndërsa kryerësi i dhunës në familje mbetet në shtëpi. Ai mbetet i qetë, ndërsa viktimat është ajo që pëson në këto raste, pra kjo ka dalë si rekomandim edhe nga dëgjimi publik dhe kërkojmë që të bëhet ndryshim -plotësimi i ligjit, që gjykata kur të vendosë të ketë bazë për këtë, që të vendosë në favor të viktimës.

Albana Gashi- Tha se në raport janë vërejtjet konkrete dhe rekomandimet e përgjithshme, sepse për t'u ndalur në detaje ky ligj nuk respektohet në asnjë nen, prandaj kemi shkuar me rekomandime të përgjithshme.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdaliu